

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Beteja për Detin e Kuq, Houthitë marrin bregdetin, Irani me një armë të re mbi botën
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/bota/beteja-per-detin-e-kuq-houthite-marrin-bregdetin-ira-ni-me-nje-a-i1185639
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:15:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 17:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2b0b40b14c08fc9ee0004bc0447d21c1310acb6e514be9af692d7cba92a7f340
TEKSTI	078dcb5f29c1eea19656557326d23f7681b0fc0baa07aa8bda2e1d48e51d0ea4
PAMJA	22044814edbbb5689a3041085aacf071e1982f08fbb82309372f7fc2713d1a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3391e3a16060004f32fd4ee39ed8bfb4043dee7027c13643205a97dcf91e8e75
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3391e3a16060004f32fd4ee39ed8bfb4043dee7027c13643205a97dcf91e8e75>


PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Beteja për Detin e Kuq, Houthisit marrin bregdetin, Irani me një armë të re mbi botën

Nga Rosalba Bejdo
22 Shtator 2026, 19:00 | Bota



Bab el-Mandebi, i njohur si "Porta e Lotëve", ndodhet mes Jemenit në Gadishullin Arabik dhe Xhibutit e Eritresë në brigjet afrikane. Në pikën e tij më të ngushtë, kanali detar është vetëm rreth 29 kilometra i gjerë dhe trafiku ndahet në dy koridore, një për anijet që hyjnë dhe një për ato që dalin, me ishullin Perim në mes. Në veri ndodhen ishujt Hanish, ndërsa në bregdetin jemenas shtrihen portet e Hodeidah dhe Mochës, dy zona që marrin rëndësi të veçantë në përpjekjen e Houthisit për të konsoliduar kontrollin e këtij korridori.

Houthisit kontrollojnë Hodeidah prej vitesh dhe e kanë përdorur këtë zonë si bazë për fushatën e tyre kundër anijeve që kalojnë në Detin e Kuq. Tani grupi po shtyn kontrollin më në jug, drejt Mochës, qytetit portual historik që lidhet me origjinën e tregtisë globale të kafesë, dhe më tej drejt Dhubabit, i cili ndodhet drejtpërdrejt pranë Bab el-Mandebit. Pikërisht ky pozicion gjeografik e bën Dhubabin një prej pikave më të rëndësishme të gjithë avancimit të Houthisit. Analisti i lartë për Jemenin në International Crisis Group, Ahmed Nagi, thotë se kontrolli i kësaj zone është veçanërisht i rëndësishëm për Houthisit sepse u mundëson të vazhdojnë më lehtë operacionet e tyre detare, ndërsa njëkohësisht krijon një mbrojtje më të fortë ndaj çdo përpjekjeje të mundshme për t'i goditur nga jugu. Sipas tij, prej kohësh ka pasur diskutime për mundësinë e një ofensive nga Arabia Saudite dhe qeveria jemenase dhe një prej drejtimeve të mundshme të saj do të ishte pikërisht zona e Mochës.

"Ky është fronti më i rëndësishëm që u ka mundësuar atyre të vazhdojnë sulmet e tyre në det, në Detin e Kuq. Në të njëjtën kohë, zgjerimi i kontrollit të tyre drejt pjesës jugore të bregdetit perëndimor është shumë i rëndësishëm për Houthisit. Mendoj se për dy arsye. E para është që t'u mundësojë të vazhdojnë operacionet e tyre ushtarake në det. Tani ata thonë se po vendosin një embargo detare ndaj anijeve të lidhura me Arabinë Saudite. Pra, duke mbajtur nën kontroll këto zona, ata mund t'i vazhdojnë operacionet e tyre shumë më lehtë. Arsyeja tjetër është se ka pasur shumë raportime se, në një moment, mund të ketë një ofensivë nga koalicioni i udhëhequr nga Arabia Saudite, nga sauditët dhe qeveria jemenase kundër Houthisit. Dhe nëse kjo do të ndodhte, ofensiva mund të niste nga Mocha, pikërisht nga kjo zonë. Prandaj, duke kontrolluar ose marrë nën kontroll këtë territor, Houthisit tani janë, në njëfarë mënyre, plotësisht të mbrojtur. Nuk ka më asnjë port përgjatë bregdetit që mund të kërcënojë kontrollin e tyre mbi bregdetin perëndimor dhe Hodeidah. Pra, Houthisit janë aktualisht në një pozicion shumë të favorshëm."

Kjo do të thotë se kontrolli i bregdetit perëndimor nuk është thjesht një zgjerim territorial për Houthisit. Ai u siguron atyre një pozicion shumë më të favorshëm për të mbrojtur Hodeidah, për të kontrolluar zonat bregdetare që shtrihen në jug dhe për të ushtruar presion mbi trafikun detar që kalon pranë brigjeve të Jemenit.

TE FUNDIT

SHBA ndërton dy baza të reja ushtarake në Groenlandë, zbulohen detaje nga marrëveshja e Trump

Vendi i NATO-s i jep dritën jeshile armëve bërthamore, Rusia paralajmëron pasoja

Zjarr i përmasave të mëdha në Gjirin e Lalzit, flakët përhapen me shpejtësi

Balla pas shkarkimit të Vlora Hysenit: PS nuk bën avokatit e askujt

MË TË VIZITUARAT

"Te SPAK-u s'ka më njeri imunitet", gazetari: Është dhënë visto nga ndërkomb...

"Minë me sahat", Qafoku nxjerr shifrat: Rama ndërro 3 ministra të Brendshëm ...

Aksident në Lezhë, humbet jetën 50-vjeçari

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

Dhe këtu nis dimensionin ndërkombëtar i kësaj beteje, sepse çdo zhvillim në këtë pjesë të Jemenit lidhet drejtpërdrejt me një prej arterieve kryesore të ekonomisë botërore.

Bab el-Mandebi është porta jugore e Kanalit të Suezit. Anijet që udhëtojnë nga Azia drejt Evropës dhe anasjelltas përdorin këtë korridor për të hyrë në Detin e Kuq dhe më pas në Kanalin e Suezit, duke shmangur një udhëtim shumë më të gjatë rreth kontinentit afrikan. Për këtë arsye, edhe një ndërprerje e pjesshme e trafikut në këtë ngushticë mund të ketë pasojë të menjëhershme për tregtinë ndërkombëtare. Drejtori ekzekutiv i Vespucci Maritime, Lars Jensen, e krahason rëndësinë e Bab el-Mandebit me vetë Kanalin e Suezit, pasi çdo mbyllje ose ndërprerje serioze e këtij korridori do të detyronte anijet që vijnë nga Azia drejt Evropës të ndryshonin rrugë dhe të lundronin rreth Kepit të Shpresës së Mirë në Afrikën e Jugut.

"Ngushtica e Bab el-Mandebit është jashtëzakonisht e rëndësishme, sepse është rruga hyrëse për të mbërritur në Kanalin e Suezit. Sigurisht, Bab el-Mandebi nuk është Kanali i Suezit, por mbyllja e Bab el-Mandebit do të ishte po aq e rëndësishme sa mbyllja e Kanalit të Suezit."

Një devijim i tillë mund t'i shtojë udhëtimit javë të tëra dhe të rrisë ndjeshëm kostot e karburantit, transportit dhe sigurimit. Pikërisht këtë e provoi industria detare pas sulmeve të Houthisve që nisën në fund të vitit 2023, kur kompani të mëdha si Maersk, MSC dhe Hapag-Lloyd ndryshuan itineraret dhe shmangën Detin e Kuq, ndërsa edhe kompanitë e energjisë devijuan një pjesë të transportit të tyre.

Fushata e Houthisve ndaj anijeve u justifikua prej tyre si një akt solidariteti me palestinezët gjatë luftës në Gaza, por pasojat u ndjenë në të gjithë zinxhirin global të furnizimit. Rritja e kostove të transportit dhe zgjatja e udhëtimeve ndikuan në tregtinë midis Azisë dhe Evropës dhe e kthyen Bab el-Mandebin në një nga pikat më të monitoruara të trafikut detar në botë.

Sipas të dhënave të Kpler, rreth 7 për qind e prodhimit global të naftës kalonte përmes Bab el-Mandebit në qershor, një shifër që tregon se sa e madhe mund të jetë pasoja e një ndërprerjeje të rëndësishme të kësaj rruge.

Por rëndësia e Bab el-Mandebit bëhet edhe më e madhe kur vendoset përballë Ngushticës së Hormuzit. Në lindje të Gadishullit Arabik ndodhet Hormuzi, rruga kryesore për eksportet e naftës nga Gjiri Persik, ndërsa në skajin tjetër ndodhet Bab el-Mandebi, porta që lidh Detin e Kuq me Oqeanin Indian dhe Kanalin e Suezit. Në këtë panoramë, roli i Iranit bëhet i pamundur të anashkalohet.

"Këtu kemi edhe dimensionin kryesor të kësaj historie, sepse Irani është i përfshirë. Për iranianët, fakti që tani po mbyllet Ngushticën e Hormuzit, ndërkohë që aleatët e tyre kryesorë, Houthisët, kontrollojnë zonat pranë Bab el-Mandebit, krijon mundësinë që më vonë edhe kjo ngushticë të mbyllet. Dhe kjo përbën një levë të rëndësishme presioni për iranianët."

Megjithatë, kontrolli i bregdetit nuk do të thotë se beteja ka përfunduar. Përkundrazi, zgjerimi i Houthisve mund të sjellë një kundërofensivë nga Arabia Saudite dhe forcat e qeverisë jemenase, ndërsa frontet mund të aktivizohen edhe në pjesë të tjera të vendit.

"Në fakt, Houthisët kanë marrë nën kontroll bregdetin perëndimor, por kjo nuk do të thotë se beteja ka përfunduar. Luftimet vazhdojnë ende dhe është e mundur të shohim një kundërofensivë nga sauditët dhe qeveria jemenase. Kjo mundësi mbetet e hapur. Madje, sauditët mund të aktivizojnë më shumë fronte në pjesën lindore, ndoshta edhe në zonat jugore të Al-Dhale dhe Al-Bayda. Pra, gjithçka mbetet e mundur dhe po flasim për dinamika që po zhvillohen ende në mes të betejës."

Në të njëjtën kohë, kompanitë e transportit po përpiqen të kuptojnë nëse situata është mjaftueshëm e qëndrueshme për t'u kthyer në itineraret normale. Disa prej tyre kanë filluar gradualisht të rikthejnë shërbimet përmes Detit të Kuq, por ky rikthim nuk do të thotë se rreziku është zhdukur. Problemi, sipas Jensen, është se sa më shumë kompani të rikthehen tani në Detin e Kuq, aq më i madh do të ishte ndikimi nëse ato do të detyroheshin sërish, brenda pak muajsh, të ndryshonin itineraret dhe të kalonin rreth Afrikës.

"Ajo që po shohim tani është se kompanitë e transportit detar po rikthehen gradualisht në normalitet dhe po rivendosin gjithnjë e më shumë shërbime përmes Detit të Kuq. Pres që ky proces të vazhdojë. Kjo do të thotë se kompanitë duhet të jenë relativisht të bindura se Houthisët, të paktën për momentin, nuk kanë ndërmend të ndryshojnë kurs. Nëse dëgjoni deklaratat e tyre të ditëve të fundit, ata kanë qenë shumë të qartë se nuk do të sulmojnë anijet ndërkombëtare, me përjashtim të anijeve saudite. Kjo tingëllon mirë, por duhet të jemi të vetëdijshëm se krijon një tjetër rrezik. Nëse të gjithë e normalizojnë tani kalimin përmes Detit të Kuq, nër shembull gjatë pjesës së fundit të vitit 2026, afër do t'i pengojë"

përmes detit të Kuq, për shkak të gjerësisë së detit të Kuq, që është një pengesë. Houthitë që në fillim të vitit 2027 ta përdorin sërish këtë avantazh si levë presioni? Nuk ka asnjë garanci që ata nuk do të ndryshojnë papritur qëndrim. Mund të shpresojmë që kjo të mos ndodhë, por rreziku mbetet. Dhe sa më shumë ta normalizojmë tani trafikun përmes Detit të Kuq, aq më të mëdha do të jenë problemet nëse papritur duhet t'i rikthehemi edhe një herë rrugës rreth Afrikës. Pra, rreziku nuk është zhdukur."

Dhe kjo është arsyeja pse beteja për Bab el-Mandebin duhet parë përtej hartës së Jemenit. Kontrolli i disa qyteteve dhe brigjeve mund të duket si një zhvillim lokal, por në këtë rast territori lidhet drejtpërdrejt me një nga rrugët që mban në lëvizje tregtinë globale.

Në njërën anë është lufta për kontrollin e Jemenit dhe për mbijetesën politike e ushtarake të Houthis; në anën tjetër është përplasja më e gjerë mes Iranit, kundërshtarëve të tij rajonalë dhe Shteteve të Bashkuara.

Dhe në mes të kësaj përplasjeje ndodhet një ngushticë vetëm 29 kilometra e gjerë, përmes së cilës kalojnë çdo ditë anije që transportojnë energji dhe mallra mes dy kontinenteve.

(A2 Televizion)

A2 CNN Livestream

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Takimi Trump-Xi, si Kina po i bën presion SHBA-së: Mos i shisni armë Tajvanit



"Gati të rihapim Hormuzin!", Irani: SHBA të heqë bllokadën, mundësi e artë në OKB



Guterres ngre alarmin nga "Pallati i Qelqtë" | "Fantazma e spastrimit etnik, në prag të Bregut Perëndimor"



"Iranin e pret ferri dhe asgjësimi total", Trump nga OKB: Marrëveshja ndoshta pas zgjedhjeve



Trump firmos marrëveshjen historike për sigurinë me Groenlandën dhe Danimarkën



Trump i bën thirrje Putinit nga OKB-ja: Mbylleni luftën në Ukrainë

Latest Videos



"Turp, video perversitetit në zyrën e Ramës" Poli Hoxha bën paralajmërimin: Prisi se ç'do të plasë



"Kush po tradhton Ramën?" Gazetarët debat të fortë me Arjan Ndojën: Trego çfarë i ke borxh Berishës



"Goditja e fortë bie shteti" Debate në studio, Arjan Ndoja bën denoncimin: Çfarë po ndodh me postat?



"Ngjarje shumë e rëndë", Qafoku: Si e rrëzoi shtetin e Kosovës dhe Shqipërisë kryespiunja Hyseni

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim


Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulo
Imagjinatë
Dëshmi



Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësiuar nga Mediaset

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.